



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		17 / 05 / 2024	
Nj. Org.	Numer	Shtojca	Vlera
01 - 060/04 - 23434			

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: 17.05.2024
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 2 <u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak ☒ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>15</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☒ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☒ <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë</i>

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhjen e mbajtur me datë 18.04.2024 u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.01.2024: <https://kk.rks-gov.net/.../procesverbali-i-mbledhjes-se.../>

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit;

3. Diskutim për migrimin në Drenas (Kërkesë për të dhëna nga MAPL);

4. Të ndryshme: Mobilizimi për pastrimin e mjedisit në Komunën e Drenasit.

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e dytë për këtë vit në sallën e Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 15 anëtarë të KKSB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit dhe drejtorë të drejtorive komunale. Mbledhja u udhëheq nga nënkryetari i komunës, z. Arben Shala.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.01.2024: <https://kk.rks-gov.net/.../procesverbali-i-mbledhjes-se.../>. Procesverbali u miratua pa ndonjë vërejtje nga anëtarët e KKSB-së.

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit. Për gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Drenasit raportoi Komandanti i Stacionit Policor në Drenas, z.Driton Morina. Ai njoftoi se në bazë të

statistikave që kanë, Drenasi është ndër komunat më të sigurta. Për më detajisht ai paraqiti disa statistika si: Në tremujorin e parë në Drenas janë 163 raste, vepra penale, lëndime të rënda 1 rast, 7 raste të vjedhjeve (në 2023 -13 raste), 7 raste të dhunës në familje (9 në tremujorin e vitit 2023). Ndërsa, numri i tiketeve dhe aksidenteve më i madh, përkatësisht 1989 fletparaqitje në tremujorin e vitit 2024.

3. Të pika e tretë, Afije Veseli nga Zyra për Komunitete njoftoi të pranishmit për një kërkesë nga MAPL që janë duke monitoruar trendin e migrimit të popullsisë pas liberalizimit të vizave, të cilët kanë kërkuar të dhëna lidhur me gjendjen në Komunën e Drenasit. “Në bazë të udhëzimit nga MAPL kemi marrë të dhënat e nevojshme nga drejtoritë përkatëse, por edhe është kërkuar të diskutohet edhe këtu në KKSBB dhe në veçanti në KLSP. Kemi marrë të dhëna nga arsimi dhe shëndetësia, por kërkoj që edhe përmes jush dhe administratorëve të kontribuoni në këtë proces në mënyrë që të kemi të dhëna sa më reale”. Lidhur me këtë pikë, nënkryetari z. Shala tha se edhe udhëheqësit e këshillave lokal mund të kontribuojnë, dhe rekomandoi një takim me ta.

4. Te pika të ndryshme u diskutua çështja e mobilizimit për pastrimin e Komunës së Drenasit më të gjithë akterët. Nënkryetari z. Shala dhe Drejtori për Shërbime Publike z. Nexhmedin Gruda, theksuan se ky aktivitet nuk do të jetë vetëm simbolik por i përmasave të mëdha më të gjithë akterët e përfshirë. Ndërsa, Arben Nika nga EVSB, njëherit edhe përfaqësues nga organizata CEDE theksoi se janë të gatshëm të ndihmojnë jo vetëm në këtë mobilizim për pastrim të mbeturinave por edhe në tjera aspekte në mjedis. Ai shprehu gatishmërinë që edhe si KKSBB të hartohet një plan i veprimit në bashkëpunim me akterë të tjerë, të dalin të bisedojnë me komunitet.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSBB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Duro
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime e potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Randi Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 17.05.2024

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.